

Gjykata Themelore Ferizaj-Dega Kaçanik, Divizioni per Kundervajtje ,dhe ate gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me procesmbajtesen Indira Beqa , punetore e kesaj gjykate ,në lenden kundërvajtëse kundër të pandehurit Shiqeri Luzha nga fsh.Begrace ,komuna e Kaçanikut , për shkak të kundërvajtjes nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1.nenpar.1.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare ,e në baze të nenit 31,73,74,199 dhe nenit 9 të Ligjit për Kundërvajtje me dt. 28.10.2013 merr këtë;

AKT V E N D I M

I pandehuri Shiqeri Luzha ,I lindur me dt.05.06.1966 ne fsh. Begrace ,komuna e Kaçanikut ,ku edhe e ka vendbanimin , shqiptar, shtetas i Republikës se Kosoves,I martuar prind i dy femijeve ,ka te kryer fakultetin , keshilltar komunal ne Asamblene komunale ne Kaçanik ,I gjendjes së mesme ekonomike,

Ë sht ë për gje gj ë s

Sepse si zyrtar i larte publik ne pozitën e keshilltarit komunal ne Asamblene Komonale ne Kaçanik ,nuk e ka bere deklarimin e rregullt vjetor te pasurise prane Agjensise Kunder Korrupsionit deri me datën 31.03.2012.

Me qka ka kryer kundervajtje nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1 nenpar.1.1 Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare

Andaj në bazë të nenit 31,73,74 dhe 199 te Ligjit per Kundervajtje dhe nenit 17 par 1 nenpar.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare,

D E N O H E T

Me denim me gjobe në shumë prej 300 € (treqind euro) ,te cilin eshte e obliguar qe ta paguaj në afat prej 15(pesëmbëdhjete) ditësh nga dita e plotfuqishmërise të këtij aktvendimi,në të kundërtën ,konform nenit 5 al.1 të Ligjit per kundërvajtje,dënimi me gjobë do t'I zevendesohet me denim me burg ashtu qe per qdo dite burgu do t'I llogariten nga 15 (Njëzet) €

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaje pranë kësaj gjykate shumë prej prej 5.00 € ne emer te paushallit gjyqesor në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërise së këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIA RESISTIV KORUPCJUE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Emri Dop. DPK/DMP	Nr. Prot. Prot. No 03-3768/13
Nr. i Hart. Dok. Stranica 03	Data Datum 07.11.2013
PRISHTINE	

A r s y e t i m

Agjensia Kunder Korrupsionit ne Prishtine , ka parshtruar kërkesen per fillimin e procedures kundervajtese nr.01-2327/12 te dates 02.07.2012 , kunder te pandehurit Shiqeri Luzha nga fsh.Begrace,komuna e Kaçanikut ,per kundervajtje nga neni 5 ,6 dhe 9 i sanksionuar me nenin 17 par 1 nenpar.3 të Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare, dhe ka kerkuar qe I njeiti te shpallet fajtor dhe te denohet sipas ligjit.

Ne baze te kerkeses se parshtruar I pandehuri eshte marre ne pyetje nga ana e gjykates me te cilin rast ka deklaruar se formularin per deklarimin e pasurise te plotesuar e ka derguar ne AKK Prishtine me date 15.05.2012 sepse sipas tij eshte neglizhuar dorezimi I formularit ne afatin e percaktuar me ligj ,por qe nuk ka patur per qellim qe t'I ik obligimit ligjor te deklarimit te pasurise .

Per vertetimin e plote te gjendjes faktike gjyqtarja ftoi ne cilesi te deshmitarit zyrtarin komunal Bejtullah Dalloshi ,I cili njeherit eshte autorizuar nga kryetari I komunes qe te sherbeje edhe si pike kontaktuese me Agjensine Kunder korrupsionit ,e I cili ne fjalen e yij deklaroi se ,lidhur me obligimin e deklarimit te pasurise te keshilltareve komunale dhe zyrtareve tjere te larte te parapare me ligj,te njejit I ka njoftuar me kohe permes postes elektronike per qka para gjykates prezentoj njoftimin e dates 02.03.2012 drejtuar keshilltareve komunale permes e mailit zyrtar dhe privat ,dhe shton se perveq kesaj ka kerkuar edhe nga kryesuesi I kuvendit komunal qe ne mbledhjen e muajit mars 2012 qe t'I njoftoje te gjithë keshilltaret komunale per obligimin ligjor te deklarimit te pasurise deri me date 31.03.2012.

Per t'u deklaruar rreth kualifikimit juridik te kundervajtjes ,gjyqtarja ftoi edhe perfaqesuesin e AKK,se ,ku me ate rast perfaqesuesi me autorizim I AKK,se Enis Sadiku deklaroi se, mbetet ne teresi prane kualifikimit juridik te kundervajtjes ,pasi qe sipas tij I pandehuri asnjehere me pare nuk e ka deklaruar pasurine e tij prane AKK,se ,gjersa ka qene ne poziten e keshilltarit komunal ,pasi qe kuptohet se edhe ligjerisht nuk ka patur obligim,e qe per kete arsye sipas tij nuk mund te konsiderohet se kemi te bejme me deklarimin e rregullt vjetor por me deklarimin sipas kerkeses se Agjensise .

Në bazë të dhënave si në kërkesë ,deklaratës së të pandehurit ,deklarates se perfaqesuesit me autorizim te AKK,se ne Prishtine dhe shkresave tjera te lendes , gjyqtarja konstatoi se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e veprës kundërvajtëse nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par.1 nenpar.1.1 pasi qe me Ligjin nr.04/L-050 te gjithë keshilltaret komunale te Asambleve komunale jane perfshire ne listen e zyrtareve te larte qe njeherit edhe kane obligim deklarimin e rregullt vjetor prane AKK,se ne Prishtine,dhe per mandatin sa jane ne kete pozite kane per obligim deklarimin e rregullt vjetor te pasurise se tyre, dhe rrjedhimisht obligimi I deklarimit te pasurise del sipas ligjit, edhe nese agjensioni nuk kerkon deklarimin e pasurise.

Andaj gjykata duke u bazuar ne te theksuarat me larte ka bere rikualifikimin juridik te kundervajtjes dhe te pandehurin conform nenit 17 par.1 nenpar.1 e shpalli përgjegjës dhe e dënoi me denim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro) , te cilin eshte I obliguar qe ta paguaje ne afat prej 15 ditesh pas plotfuqishmerise se ketij aktvendimi ne te kunderten conform

